

VENDIM
Nr. 25, datë 18.4.2016

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE TË GRANTIT “ARSIMI”,
THIRRJA E PARË, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE
RAJONALE, SHTYLLA I, PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte të reja, thirrja e parë, për vitin 2016, për grantin e arsimit, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, sipas tabelës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për t’u financuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në sekretariatin teknik, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për informim.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fillim të tremujorit të tretë të vitit 2016. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën të rishqyrtojë financimin dhe t’i rishpër-ndajë ato për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të kryejë monitorimin e ecurisë së përdorimit të fondeve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi, dhe të informojë Ministrinë e Financave, dhe periodikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Lista e projekte të reja për financim, thirrja e parë, përmes grantit të arsimit. Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, për vitin 2016.

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i Projektit	Kodi i programit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
QARKU BERAT						
1	Bashkia Ura Vajgurore	Rikonstruksioni shkollës 9-vjecare Andrea Mbrice, Poshnje, Bashkia Ura Vajgurore	9120	54,685,184	27,342,592	27,342,592
QARKU DIBER						
2	Bashkia Diber	Ndërtimi i shkollës së mesme Maqellare	9230	95,610,980	47,805,490	47,805,490
3	Bashkia Bulqize	Rikonstruksioni shkollave të njesise administrative Shupenze, Bashkia Bulqize	9120	87,170,894	43,585,447	43,585,447
QARKU DURRËS						
4	Bashkia Shijak	Ndërtimi i shkollës 9-vjecare fshati Shtraze, Gjepalaj	9120	46,220,996	23,110,498	23,110,498
5	Bashkia Durres	Ndërtim i shkollës 9-vjecare "Marie Kaculini", Durres	9120	143,959,125	71,979,563	71,979,563
QARKU ELBASAN						
6	Bashkia Elbasan	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "Qamil Guranjaku"	9120	65,598,953	32,799,477	32,799,477
7	Bashkia Librazhd	Rikonstruksion kopshti i femijeve nr.2, Qyteti Librazhd, Bashkia Librazhd	9120	8,800,000	4,400,000	4,400,000
8	Bashkia Cerrik	Ndërtimi i shkollës, ndërtimi i palestres, terrenet sportive dhe sistemimi i territorit të shkolles 9-vjecare Adem Elmas Asllani" Shtëpanje, njesia Gostime, Cerrik	9121	73,073,515	36,536,758	36,536,758
QARKU FIER						
9	Bashkia Fier	Rikonstruksion ishkolles "Perikli Ikonomi", Bashkia Fier	9230	44,222,256	22,111,128	22,111,128
10	Bashkia Fier	Rikonstruksioni shkolles 9-vjecare "Dino Ismaili", Levan, Bashkia Fier	9120	26,276,769	13,138,385	13,138,385
11	Bashkia Divjake	Rikonstruksion i shkolles Koli Allkanjari, Kemishtaj, Komuna Gradisht	9230	81,827,392	40,913,696	40,913,696
QARKU GJIROKASTËR						
12	Bashkia Tepelene	Rikonstruksion i plote i shkolles se mesme te pergjithshme "Abaz Shehu", Bashkia Tepelene	9230	64,228,054	32,114,027	32,114,027
13	Bashkia Memaliaj	Rikonstruksioni shkolles 9-vjecare "Nimete Progonati", Bashkia Memaliaj	9120	35,924,340	17,962,170	17,962,170
QARKU KORÇË						
14	Bashkia Korce	Ndërtim shkolle e re ne fshatin Kamenice		40,000,000	20,000,000	20,000,000
15	Bashkia Korce	Rikonstruksioni kopshtit nr 11 ne qytetin e Korces		10,400,000	5,200,000	5,200,000
16	Bashkia Pogradec	Rikonstruksioni objektit dhe terreneve sportive te shkolles 9-vjecare "Kozma Gjoke Basho"	9120	86,700,457	43,350,229	43,350,229
17	Bashkia Maliq	Ndërtim shkolla e mesme e bashkuar, Rrembec, Bashkia Maliq	9230	87,855,104	43,927,552	43,927,552

QARKU LEZHË						
18	Bashkia Kurbin	Rikonstruksion i shkollesmesme "At ShqefenGjecovi" Bashkia Lac	9230	156,000,000	78,000,000	78,000,000
19	Bashkia Mirdite	Rikonstruksioni , sistem ngrohje, sistemim dhe rijetezim i terreneve sportive shkola e mesme Rreshen, Bashkia Rreshen	9230	118,918,874	59,459,437	59,459,437
20	Bashkia Lezhe	Rikonstruksion shkola e mesme, Gjader	9230	29,526,350	14,763,175	14,763,175
QARKU SHKODËR						
21	Bashkia Vau i Dejes	Ndertim i shkolles 9-vjecare "Don Martin Trushi" Stajke, Komuna Bushat	9120	72,132,616	36,066,308	36,066,308
22	Bashkia Malsi e Madhe	Rikonstruksion shkola 9-vjecare "Preke Gjoni" Bajze	9120	10,968,317	5,484,159	5,484,159
23	Bashkia Puke	Ndertim palestres prane shkolles "Sabah Sinani" dhe "Migjeni", Puke	9120	54,476,354	27,238,177	27,238,177
QARKU TIRANË						
24	Bashkia Kavaje	Ndertimi i shkolles 9-vjecare "Rilindja", Lagja nr.1 Kavaje	9120	99,997,726	49,998,863	49,998,863
25	Bashkia Tirane	Rikonstrukion i shkolles koreografike Tirane	9230	63,994,120	31,997,060	31,997,060
QARKU VLORE						
26	Bashkia Konispol	Rikonstruksion+ndertim i palestres së shkolles se bashkuar "Bejdo Sejko", Konispol	9230	80,379,965	40,189,983	40,189,983
27	Bashkia Vlore	Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Ali Demi", Bashkia Vlore	9230	199,475,379	93,237,690	106,237,690
TOTALI				1,938,423,720	962,711,860	975,711,860

Shënim:

1. "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoritetet kontraktuese). Kjo vlerë shërben si referencë për përlllogaritjen e vlerës së financimit për vitin 2016, dhe korrektohet nga vlera e kontratës, pas nënshkrimit të saj. Fondi i përfutur nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës, pas nënshkrimit të kontratës, i shtohet portofolit të grantit "Arsimi", Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, dhe shpërndahet për financimin e projekteve të reja. Vlera e plotë e projektit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit).
2. "Vlera e financimit për vitin 2016" tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti, për vitin 2016.
3. "Vlera e financimit", për vitin 2017, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së financimit për vitin 2016.
4. Vlera e totalit të financimit për vitin 2016 përbëhet nga granti i arsimit, si dhe nga fondi i projektit "Rikonstruksioni i shkollës koreografike, Tiranë", i cili kaloi nga fondet e Ministrisë së Arsimit në Fondin për Zhvillimin e Rajoneve, me Vendim Nr. 13 të KZHR, datë 10.03.2016